



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 7578/prot.

Tiranë, më 01.10.2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. Nr.1809, datë 08.07.2016.

**SHOQËRISË “KUQI - 2015” SH.P.K**

Lagjja Uji i bardhë, Banesë private 1-katëshe, Zona kadastrale 1768, Nr. pasurie 209/12  
Gjorm, Mamurras, Lezhë

Për dijëni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA**  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “KUQI - 2015” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1809, datë 08.07.2016, për mineralin gur gëlqeror, në Objektin “Gjorm”, Bashkia Kurbin, Qarku Lezhë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 4429, datë 02.10.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 7578 Prot., datë 03.10.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1809, datë 08.07.2016, për mineralin gur gëlqeror, në Objektin “Gjorm”, Bashkia Kurbin, Qarku Lezhë, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në

Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1809, datë 08.07.2016, për mineralin gur gëlqeror në Objektin “Gjorm”, Bashkia Kurbin, Qarku Lezhë, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1809, datë 08.07.2016, për mineralin gur gëlqeror, në Objektin “Gjorm”, Bashkia Kurbin, Qarku Lezhë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
DHE  
MINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

**ME URDHËR PËR DELEGIM**

**ZËVENDËSMINISTRI**

**GENI KLOSI**

